



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERËT PUBLIKË  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr.\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

Lënda: Mbi projektbuxhetin e Institucionit të Komisionerëve Publikë, për periudhën afatmesme 2023-2025

**KUVENDIT TË SHQIPËRISË  
KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË  
DREJTAT E NJERIUT**

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 4, Tiranë

**MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

Të nderuar,

Institucioni i Komisionerëve Publikë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimit nr. 7, datë 28.2.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, dhe udhëzimit nr. 9, datë 28.2.2022, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, ka përmbushur detyrimin ligjor për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2023-2025.

Kërkesat buxhetore për periudhën 2023-2025 janë përgatitur duke respektuar rregullat dhe procedurat standarde të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm për fazën I, strategjike.

Duke marrë në konsideratë përfundimin e mandatit kushtetues të institucionit më 31.12.2024, këto kërkesa janë hartuar nga Ekipi i Menaxhimit të Programit dhe miratuar nga GMS-ja, vetëm për vitet 2023, 2024, siç paraqiten në tabelën në vijim:

000 lekë

Emërtimi	Viti 2022	Viti 2023		Viti 2024	
		Kërkesa	Tavane	Kërkesa	Tavane
<b>TOTALI</b>	<b>75,528</b>	<b>82,400</b>	<b>72,200</b>	<b>82,100</b>	<b>72,200</b>
600. Paga	59,528	64,300	56,700	64,300	56,700
601. Sigurime shoqërore	6,600	7,100	6,600	7,100	6,600
602. Mallra dhe shërbime	7,400	9,500	7,400	9,200	7,400
231. Aktive të trupëzuara	2,000	1,500	1,500	1,500	1,500

Tavanet përgatitore të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e PBA-së 2023-2025 janë miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 130, datë 2.3.2022, “Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve për PBA-në 2023-2025”. Për Institucionin e Komisionerëve Publikë këto tavane, për vitin 2023 dhe 2024, siç vërehet më lart, nuk përputhen me kërkesat buxhetore të institucionit në shpenzime korente, gjithashtu janë edhe më të ulëta krahasimisht me buxhetin e miratuar për vitin 2022.

Kërkesat buxhetore janë hartuar bazuar në eksperiencën e katër viteve të aktivitetit, nevojave aktuale për mallra dhe shërbime, si dhe detyrimeve ligjore në fushën e pagave dhe më gjerë.

Më poshtë ju paraqesim të detajuara kërkesat buxhetore për shpenzimet korente dhe shpenzimet kapitale sipas klasifikimit ekonomik dhe argumentet përkatëse.

## I- Shpenzime personeli

Fondi i pagave dhe i sigurimeve shoqërore është përllogaritur nga institucioni bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore dhe, konkretisht, në nenin C, të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, të ndryshuar me Vendimin 102/2018, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”, Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë dhe Rregulloren “Për veprimtarinë e Institucionit të Komisionerëve Publikë”.

Kërkesa buxhetore në shpenzime personeli për vitin 2023, për punonjësit e institucionit, është rreth 71,400 mijë lekë.

Në mënyrë analitike janë përllogaritur elementet e pagave, si më poshtë vijon:

**I.1 Fondi vjetor për pagën fillestare për Komisionerët Publikë dhe Njësinë Ligjore sipas akteve ligjore të përmendura më lart dhe pagës bazë për Njësinë Administrative, në vlerë rreth 46,550 mijë lekë.**

**I.2 Shtesa për vjetërsi, e llogaritur:**

- a) Për Komisionerët Publikë, bazuar në nenin 29, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 12, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- b) Për Këshilltarët, në masën 80% të shtesës për vjetërsi të Komisionerëve, bazuar në nenin 29, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet që Këshilltari ligjor dhe ekonomik përfiton përkatësisht 80 për qind të pagës mujore përkatëse. Në nenin 109 të Kodit të Punës përkufizohet se: “*me pagë kuptohet paga bazë, si dhe shtesat me karakter të përhershëm*”, dhe, në këtë kuptim, shtesa për vjetërsi, si një element i gjithëpranuar i pagës së punonjësve në njësitë publike, aplikohet edhe për Këshilltarët e Njësisë Ligjore në Institucionin e Komisionerëve Publikë.
- c) Për stafin administrativ, si element i strukturës së pagave për të gjithë punonjësit e njësisive publike.

**I.3 Shtesat të tjera mbi pagë, e llogaritur:**

- a) Shtesë për vështirësi për Komisionerët Publikë, bazuar në nenin 29, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-në nr. 574, datë 9.10.2017, “Për përcaktimin e pagesës mujore shtesë për shkak të vështirësisë, për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit”. Shtesa për vështirësi për Komisionerët Publikë aplikohet në masën 50% të pagës bruto fillestare.
- b) Shtesa për pozicion drejtues për Komisionerët Publikë, bazuar në nenin C të aneksit të Kushtetutës, nenin 29, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, nenin 12, germa “ç”, të ligjit nr. 96/2016. Komisionerët Publikë, në cilësinë e titullarëve të institucionit, me të drejtën e njohur nga këto akte ligjore, përfitojnë shtesë mbi pagë, për drejtim, në masën 10% të pagës bruto fillestare.
- c) Shtesë për vështirësi për Njësinë Ligjore, bazuar në nenin 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se Këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë, sipas rastit.

Bazuar në nenin 4 të rregullores së institucionit, Mbledhja e Komisionerëve, si organi kolegjal drejtues i institucionit, miraton dhënien e shtesës mbi pagë sipas rastit.

Rregullorja: “Për veprimtarinë e Institucionit të Komisionerëve Publikë” është akt nënligjor, i hartuar bazuar në nenin 69, të ligjit nr. 84/2016, në të cilin citohet se Mbledhja e Anëtarëve të Komisionit, Mbledhja e Gjyqtarëve dhe Mbledhja e Komisionerëve Publikë kanë detyrimin të miratojnë rregullat për veprimtarinë e institucioneve përkatëse të rivlerësimit.

Sa më sipër, Mbledhja e Komisionerëve, me Vendimin nr. 3, datë 22.4.2022, ka përcaktuar kriteret për dhënien e pagesës shtesë për shkak të vështirësisë për Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, si dhe masën e dhënies së kësaj shtese jo më shumë se 3 paga mujore në vit.

Për stafin administrativ (për punonjësit mbështetës, Specialistin e IT-së dhe Specialistin e Protokoll/Arkivit) është llogaritur shtesë për vështirësi për kushte pune, bazuar në vendimin e Kuvendit nr. 102/2018, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”, VKM-në nr. 717, datë 23.6.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, dhe VKM-në nr. 187, datë 8.3.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë...”.

Gjithashtu është përlogaritur, pas diskutimeve në Komisionin e Ligjeve, për miratimin e shtesës për kushte të veçanta pune për punonjësit administrativë, në masën 10% të shtesës për funksion, si dhe riklasifikimi i pagave për 3 specialistë të Njesisë Administrative, sipas kërkesës së institucionit.

## **II. Shpenzime operative**

Buxheti në shpenzime operative garanton blerjen e mallrave dhe shërbimeve të domosdoshme, në mbështetje të ushtrimit të funksioneve që Kushtetuta dhe ligji i cakton Komisionerëve Publikë.

Buxheti i parashikuar në shpenzime operative, për vitet 2023 dhe 2024, është përlogaritur bazuar në historikun e këtyre shpenzimeve në periudhat e kaluara, si dhe nevojat aktuale, duke marrë parasysh që për shkak të pakësimit të fondeve buxhetore me akt normativ dhe rishpërndarjes së tyre brenda shpenzimeve korente, një pjesë e shpenzimeve të planifikuara për vitin 2022 nuk do të realizohen apo do të reduktohen. Mund të përmendim në këtë rast mosrealizimin e procedurës për sigurimin e jetës dhe shëndetit të Komisionerëve Publikë dhe punonjësve të tjerë të Institucionit, si dhe rishikimin e fondeve të parashikuara për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, për shkak të rritjes së çmimeve. Për rrjedhojë, kërkesa e institucionit prej 9,500 mijë lekë, në shpenzime operative, e cila do të detajohet në vijim, tejkalon tavanet përgatitore të miratuara nga Këshilli i Ministrave, përlogaritur sa buxheti i vitit 2022, që është në vlerën 7,400 lekë.

Sipas grupeve kryesore të shpenzimeve operative, kërkesa buxhetore paraqitet në vijim:

## **602.0 - Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme**

Në këtë grup përfshihen shpenzimet për: letër, kancelari, tonera, shtypshkrime, materiale pastrimi dhe higjienizimi etj. Kërkesa për këto shpenzime për vitin 2023, në total, është rreth 1,490 mijë lekë. Në përlllogaritjen e këtij fondi janë mbajtur në konsideratë shpenzimet e pritshme për vitin 2022, nevojat e evidentuara gjatë aktivitetit të institucionit, si dhe rritja e çmimeve për pothuajse të gjitha mallrat.

## **602.1 - Materiale dhe shërbime speciale**

Në këtë grup përfshihen shpenzimet për: uniforma, botime, si dhe blerje ujë të pijshëm. Kërkesa për këto shpenzime për vitin 2023, në total, është rreth 240 mijë lekë.

## **602.2 - Shërbime nga të tretët**

Në këtë grup përfshihen shpenzimet për: energji elektrike, ujë, shpenzime telefonike, shërbime të tjera etj. Kërkesa për këto shpenzime për vitin 2023, në total, është rreth 2,700 mijë lekë.

- Grupi i shpenzimeve për energji, ujë, postë, abonime etj., është parashikuar bazuar në shpenzimet e kryera nga institucioni në vitin 2021, ecurinë e këtyre shpenzimeve në vitin aktual, si dhe parashikimi në rast të rritjes së çmimit.

- Sa i takon përlllogaritjeve të shpenzimeve të telefonisë celulare, i jemi referuar VKM-së nr. 673, datë 2.9.2020, “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, të ndryshuar me VKM-në nr. 855, datë 4.11.2020.

- Shpenzimet për shërbim parkimi, abonime, shpenzime të trajnimeve etj., janë parashikuar bazuar në historikun e këtyre shpenzimeve, si dhe parashikimi i tyre në vitin aktual.

## **602.3 - Shpenzime transporti**

Në këtë grup përfshihen shpenzimet për karburant, goma, pjesë këmbimi, siguracione, larje etj., për automjetin e institucionit ku është marrë parasysh edhe rritja e çmimit të karburantit. Fondi total i parashikuar për këtë grup për vitin 2023, është 490 mijë lekë.

## **602.4 - Shpenzime udhëtimi**

Në këtë grup përfshihen shpenzimet për udhëtim dhe dieta, për pjesëmarrje në trajnime dhe konferenca jashtë vendit, bazuar në legjislacionin në fuqi, referuar VKM-së nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. Këto shpenzime nuk janë realizuar për shkak të pandemisë dhe kufizimit të lëvizjes, dhe, meqenëse situata në këtë drejtim është përmirësuar, për vitin 2023, fondi total i parashikuar për këto shpenzime është rreth 1,200 mijë lekë.

## **602.5 - Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme**

Fondi i parashikuar për këto shpenzime për vitin 2023, është rreth 850 mijë lekë, në të cilin janë përfshirë: mirëmbajtja e pajisjeve të zyrave, pajisjeve teknike dhe elektrike, sistemit të kondicionimit, mirëmbajtje godine, mirëmbajtje automjeti etj.

## **602.9 - Shpenzime të tjera operative**

Në këtë grup përfshihen shpenzimet për pagesën e detyrimeve ndaj sistemit tatimor, shpenzime për pjesëmarrje në konferenca të ndryshme jashtë vendit, sigurimin e jetës dhe shëndetit të punonjësve, në vlerë totale rreth 2,730 mijë lekë. Procedura për sigurimin e jetës dhe shëndetit të Komisionerëve Publikë dhe punonjësve të tjerë të institucionit, edhe pse ishte parashikuar të realizohet edhe gjatë vitit 2022 etj., nuk do të realizohet për shkak të reduktimit të fondeve në shpenzime korente me akt normativ të Këshillit të Ministrave.

Kërkesat për shpenzime operative, siç theksuam dhe më lart, janë hartuar të plota për vitet 2023 dhe 2024, ndërsa për vitin 2025 kërkesat buxhetore janë zero, për shkak të parashikimit kushtetues lidhur me mandatin e institucionit.

## **III. Shpenzimet administrative kapitale**

Për sa i përket shpenzimeve administrative kapitale, kërkesat buxhetore të institucionit janë bazuar në tavanet përgatitore dhe, në vijim gjatë fazës së dytë të PBA-së 2023-2025, do të rishikohen, duke përcaktuar qartë nevojat në këtë drejtim.

Bashkëlidhur gjeni të gjitha formatet e plotësuar sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Me respekt,

## **KOMISIONERËT PUBLIKË**

**Florian Ballhysa**

**Darjel Sina**

FORMAT 2: FORMATI STANDARD I PËRGATITJES SË KËRKESAVE BUXHETORE PBA 2022-2024

Buxheti 2023-2025

Emërtimi i Programit Buxhetor	Veprimtaria e Komisionerit Publik			
Kodi i Programit	03360			
Programi Buxhetor Afatmesëm	2023-2025			
<b>Përshkrimi i Programit</b>				
Veprimtaria e Komisionerit Publik				
Qëllimet e Politikës së Programit	Procesi i Rivleresimit të gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë ka për qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi			
Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	2022 Buxheti	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	2025 Parashikimi
Numer ankimesh ose mosankimesh të publikuara brenda afatit ligjor	100%	100%	100%	0%
Objektivi 1 i Politikës së Programit	Mbrojtja e interesit publik gjatë kryerjes së procesit të rivleresimit, respektimi i parimit të paanësisë dhe pavarësisë, procesit të rregullt ligjor, transparencës dhe frymës së bashkëpunimit ndërmjet dy komisioneve publike, Operacionit Nderkombëtar të Monitorimit dhe institucioneve të tjera."			
Treguesit e Performancës për Objektivin 1				
		Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites
Numer Çështjesh të njoftuara nga KPK, të shqyrtuara nga Komisionerët Publikë brenda afateve ligjore	160	85	85	
<b>Produktet për Objektivin 1</b>				
<b>Shpenzimet Korrente*</b>				
<b>Produkti 1</b>	Vendime të shqyrtuara			
Përshkrimi i Produktit:	Shqyrtim i vendimeve të njoftuara nga KPK			
Njësia Matëse	Numer vendimesh			
	2022 Buxheti	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	2025 Parashikimi
Sasia	160	85	85	0
Kosto totale (në mijë lekë)	73,528	80,900	80,600	0
Kosto për njësi (në mijë lekë)	460	952	948	#DIV/0!
Ndryshimi në % i Sasisë	...	-46.9%	0.0%	-100.0%
Ndryshimi në % i kostos totale	...	10.0%	-0.4%	-100.0%
Ndryshimi në % i kostos për njësi	...	107.1%	-0.4%	#DIV/0!
<b>Detajimi i Kostos Totale të Produktit 1 sipas Artikujve Ekonomikë</b>				
	2022	2023	2024	2025





	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
600. Pagat	59,528	64,300	64,300	0
<i>Kapitulli 01</i>	<i>59,528</i>	<i>64,300</i>	<i>64,300</i>	<i>0</i>
<i>Kapitulli 05</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shendetësore	6,600	7,100	7,100	0
<i>Kapitulli 01</i>	<i>6,600</i>	<i>7,100</i>	<i>7,100</i>	<i>0</i>
<i>Kapitulli 05</i>				
602. Mallrat dhe shërbimet	7,400	9,500	9,200	
<i>Kapitulli 01</i>	<i>7,400</i>	<i>9,500</i>	<i>9,200</i>	<i>0</i>
<i>Kapitulli 05</i>				
603. Subvencionet				
<i>Kapitulli 01</i>				
<i>Kapitulli 05</i>				
604. Transfera të brendshme				
<i>Kapitulli 01</i>				
<i>Kapitulli 05</i>				
605. Transfera të jashtme				
<i>Kapitulli 01</i>				
<i>Kapitulli 05</i>				
606. Transfera për familjet dhe individët	0	0	0	0
<i>Kapitulli 01</i>				
<i>Kapitulli 05</i>				
<b>Kosto totale e produktit 1</b>	<b>73,528</b>	<b>80,900</b>	<b>80,600</b>	<b>0</b>
<b>Kontroll</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Shpenzimet Kapitale***</b>				
<b>Kategoria 1: Shpenzimet Administrative Kapitale</b>				
<b>Kodi i Projektit të Investimeve****</b>	<b>Orendi/Pajisje/Mjete</b>			
<b>Produkti 1</b>	<b>Pajisje elektronike</b>	<b>Kodi i Projektit sipas listes se investimeve</b>	M630013	
<b>Përshkrimi i Produktit:</b>	Blerje pajisje elektronike			
<b>Njësia Matëse</b>	sete pune			
	2022	2023	2024	2025



	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	4	3	3	0
Kosto totale (në mijë lekë)	1,000	650	650	0
Kosto për njësi (në mijë lekë)	250	217	217	#DIV/0!
Ndryshimi në % i Sasisë	...	-25.0%	0.0%	-100.0%
Ndryshimi në % i kostos totale	...	-35.0%	0.0%	-100.0%
Ndryshimi në % i kostos për njësi	...	-13.3%	0.0%	#DIV/0!
<b>Detajimi i Kostos Totale të Produktit 1 sipas Artikujve Ekonomikë</b>				
	2022	2023	2024	2025
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
230. Aktive të patrupëzuara	0	0	0	0
<i>Kapitulli 01</i>				
<i>Kapitull 02</i>				
<i>Kapitulli 03</i>				
<i>Kapitulli 04</i>				
231. Aktive të trupëzuara	1,000	650	650	0
<i>Kapitulli 01</i>	1,000	650	650	0
<i>Kapitull 02</i>				
<i>Kapitulli 03</i>				
<i>Kapitulli 04</i>				
<b>Kosto totale e produktit 1</b>	1,000	650	650	0
<b>Kodi i Projektit të Investimeve****</b>				
<b>Orendi/Pajisje/Mjete</b>				
<b>Produkti 2</b>	<b>Mobilje Zyre</b>	<b>Kodi i Projektit sipas listes se investimeve</b>	<b>M630002</b>	
Përshkrimi i Produktit:	Blerje mobilje zyre			
Njësia Matëse	Sete Pune			
	2022	2023	2024	2025
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	4	3	3	0
Kosto totale (në mijë lekë)	1,000	850	850	0
Kosto për njësi (në mijë lekë)	250	283	283	#DIV/0!

Ndryshimi në % i Sasisë	...	-25.0%	0.0%	-100.0%
Ndryshimi në % i kostos totale	...	-15.0%	0.0%	-100.0%
Ndryshimi në % i kostos për njësi	...	13.3%	0.0%	#DIV/0!
<b>Detajimi i Kostos Totale të Produktit 2 sipas Artikujve Ekonomikë</b>				
	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
	<b>Buxheti</b>	<b>Parashikimi</b>	<b>Parashikimi</b>	<b>Parashikimi</b>
230. Aktive të patrupëzuara	0	0	0	0
<i>Kapitulli 01</i>				
<i>Kapitull 02</i>				
<i>Kapitulli 03</i>				
<i>Kapitulli 04</i>				
231. Aktive të trupëzuara	1,000	0	0	0
<i>Kapitulli 01</i>	1,000		0	0
<i>Kapitull 02</i>				
<i>Kapitulli 03</i>				
<i>Kapitulli 04</i>				
<b>Kosto totale e produktit 2</b>	1,000	0	0	0
<b>Totali i shpenzimeve të Programit sipas produkteve*****</b>	75,528	82,400	82,100	0
<b>Totali i shpenzimeve të Programit sipas artikujve*****</b>	75,528	81,550	81,250	0
600. Pagat	59,528	64,300	64,300	0
<i>Kapitulli 01</i>	50,600	64,300	64,300	0
<i>Kapitull 05</i>	0	0	0	0
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shendetësore	6,600	7,100	7,100	0
<i>Kapitulli 01</i>	6,600	7,100	7,100	0
<i>Kapitull 05</i>	0	0	0	0
602. Mallrat dhe shërbimet	7,400	9,500	9,200	0
<i>Kapitulli 01</i>	7,400	9,500	9,200	0
<i>Kapitull 05</i>	0	0	0	0
603. Subvencionet	0	0	0	0
<i>Kapitulli 01</i>	0	0	0	0
<i>Kapitull 05</i>	0	0	0	0
604. Transferta të brendshme	0	0	0	0

Kapitulli 01	0	0	0	0
Kapitull 05	0	0	0	0
605. Transferta të jashtme	0	0	0	0
Kapitulli 01	0	0	0	0
Kapitull 05	0	0	0	0
606. Transferta për familjet dhe individët	0	0	0	0
Kapitulli 01	0	0	0	0
Kapitull 05	0	0	0	0
230. Aktivët e patrupëzuara	0	0	0	0
Kapitulli 01				
Kapitull 02				
Kapitulli 03				
Kapitulli 04				
231. Aktivët e trupëzuara	2,000	650	650	0
Kapitulli 01	2,000	650	650	0
Kapitull 02				
Kapitulli 03				
Kapitulli 04				
<b>Kontroll</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Koordinatori i GMS/ Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Nenshkrimi			Nenshkrimi	
	Data	26.4.2022		Data	26.4.2022



**FORMAT 2: FORMATI STANDARD I PËRGATITJES SË KËRKESAVE BUXHETORE PBA 2022-2024**  
**Buxheti 2023-2025 (TAVANET)**


<b>Emërtimi i Programit Buxhetor</b>	Veprimtaria e Komisionerit Publik			
<b>Kodi i Programit</b>	03360			
<b>Programi Buxhetor Afatmesëm</b>	2023-2025			
<b>Përshkrimi i Programit</b>				
Veprimtaria e Komisionerit Publik				
<b>Qëllimet e Politikës së Programit</b>	Procesi i Rivleresimit të gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë ka për qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi			
Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	<b>2022 Buxheti</b>	<b>2023 Parashikimi</b>	<b>2024 Parashikimi</b>	<b>2025 Parashikimi</b>
Numer ankimesh ose mosankimesh të publikuara brenda afatit ligjor	100%	100%	100%	0%
<b>Objektivi 1 i Politikës së Programit</b>	Mbrotjtja e interesit publik gjatë kryerjes së procesit të rivleresimit, respektimi i parimit të paansisë dhe pavarësisë, procesit të rregullt ligjor, transparencës dhe frymës së bashkëpunimit ndërmjet dy komisioneve publike, Operacionit Nderkombëtar të Monitorimit dhe institucioneve të tjera."			
Treguesit e Performancës për Objektivin 1				
		Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites
Numer Çështjesh të njoftuara nga KPK, të shqyrtuara nga Komisionerët Publikë brenda afateve ligjore	160	85	85	0
<b>Produktet për Objektivin 1</b>				
<b>Shpenzimet Korrente*</b>				
<b>Produkti 1</b>	Vendime të shqyrtuara			
Përshkrimi i Produktit:	Shqyrtim i vendimeve të njoftuara nga KPK			
Njësia Matëse	Numer vendimesh			
	<b>2022 Buxheti</b>	<b>2023 Parashikimi</b>	<b>2024 Parashikimi</b>	<b>2025 Parashikimi</b>
Sasia	160	85	85	0
Kosto totale (në mijë lekë)	73,528	70,700	70,700	70,900
Kosto për njësi (në mijë lekë)	460	832	832	#DIV/0!
Ndryshimi në % i Sasisë	...	-46.9%	0.0%	-100.0%
Ndryshimi në % i kostos totale	...	-3.8%	0.0%	0.3%
Ndryshimi në % i kostos për njësi	...	81.0%	0.0%	#DIV/0!
<b>Detajimi i Kostos Totale të Produktit 1 sipas Artikujve Ekonomikë</b>				
	<b>2022 Buxheti</b>	<b>2023 Parashikimi</b>	<b>2024 Parashikimi</b>	<b>2025 Parashikimi</b>
600. Pagat	59,528	56,700	56,700	56,700
<i>Kapitulli 01</i>	<i>59,528</i>	<i>56,700</i>	<i>56,700</i>	<i>56,700</i>
<i>Kapitulli 05</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shendetësore	6,600	6,600	6,600	6,800


Kapitulli 01	6,600	6,600	6,600	6,800
Kapitulli 05				
602. Mallrat dhe shërbimet	7,400	7,400	7,400	7,400
Kapitulli 01	7,400	7,400	7,400	7,400
Kapitulli 05				
603. Subvencionet				
Kapitulli 01				
Kapitulli 05				
604. Transferta të brendshme				
Kapitulli 01				
Kapitulli 05				
605. Transferta të jashtme				
Kapitulli 01				
Kapitulli 05				
606. Transferta për familjet dhe individët	0	0	0	0
Kapitulli 01				
Kapitulli 05				
<b>Kosto totale e produktit 1</b>	<b>73,528</b>	<b>70,700</b>	<b>70,700</b>	<b>70,900</b>
<b>Kontroll</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Detajimi i Kostos Totale të Produktit X sipas Artikujve Ekonomikë</b>				
<b>Shpenzimet Kapitale***</b>				
<b>Kategoria 1: Shpenzimet Administrative Kapitale</b>				
<b>Kodi i Projektit të Investimeve****</b>	<b>Orendi/Pajisje/Mjete</b>			
<b>Produkti 1</b>	Pajisje elektronike	Kodi i Projektit sipas listes se investimeve	M630013	
Përshkrimi i Produktit: Blerje pajisje elektronike				
Njësia Matëse sete pune				
	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
	<b>Buxheti</b>	<b>Parashikimi</b>	<b>Parashikimi</b>	<b>Parashikimi</b>
Sasia	4	3	3	0
Kosto totale (në mijë lekë)	1,000	850	850	850
Kosto për njësi (në mijë lekë)	250	283	283	#DIV/0!
Ndryshimi në % i Sasisë	...	-25.0%	0.0%	-100.0%
Ndryshimi në % i kostos totale	...	-15.0%	0.0%	0.0%
Ndryshimi në % i kostos për njësi	...	13.3%	0.0%	#DIV/0!
<b>Detajimi i Kostos Totale të Produktit 1 sipas Artikujve Ekonomikë</b>				
	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
	<b>Buxheti</b>	<b>Parashikimi</b>	<b>Parashikimi</b>	<b>Parashikimi</b>
230. Aktive të patrupëzuara	0	0	0	0
Kapitulli 01				
Kapitulli 02				
Kapitulli 03				
Kapitulli 04				
231. Aktive të trupëzuara	1,000	850	850	850
Kapitulli 01	1,000	850	850	850
Kapitulli 02				




<i>Kapitulli 03</i>				
<i>Kapitulli 04</i>				
<b>Kosto totale e produktit 1</b>	1,000	850	850	850
<b>Kodi i Projektit të Investimeve****</b>				
<b>Orendi/Pajisje/Mjete</b>				
<b>Produkti 2</b>	Mobilje Zyre	<b>Kodi i Projektit sipas listes se investimeve</b>	M630002	
Përshkrimi i Produktit:	Dierje mobilje zyre			
Njësia Matëse	Sete Pune			
	<b>2022 Buxheti</b>	<b>2023 Parashikimi</b>	<b>2024 Parashikimi</b>	<b>2025 Parashikimi</b>
Sasia	4	3	3	0
Kosto totale (në mijë lekë)	1,000	650	650	650
Kosto për njësi (në mijë lekë)	250	217	217	#DIV/0!
Ndryshimi në % i Sasisë	...	-25.0%	0.0%	-100.0%
Ndryshimi në % i kostos totale	...	-35.0%	0.0%	0.0%
Ndryshimi në % i kostos për njësi	...	-13.3%	0.0%	#DIV/0!
<b>Detajimi i Kostos Totale të Produktit 2 sipas Artikujve Ekonomikë</b>				
	<b>2022 Buxheti</b>	<b>2023 Parashikimi</b>	<b>2024 Parashikimi</b>	<b>2025 Parashikimi</b>
230. Aktive të patrupëzuara	0	0	0	0
<i>Kapitulli 01</i>				
<i>Kapitulli 02</i>				
<i>Kapitulli 03</i>				
<i>Kapitulli 04</i>				
231. Aktive të trupëzuara	1,000	650	650	650
<i>Kapitulli 01</i>	1,000	650	650	650
<i>Kapitulli 02</i>				
<i>Kapitulli 03</i>				
<i>Kapitulli 04</i>				
<b>Kosto totale e produktit 2</b>	1,000	650	650	650
<b>Totali i shpenzimeve të Programit sipas produkteve*****</b>				
	75,528	72,200	72,200	72,400
<b>Totali i shpenzimeve të Programit sipas artikujve*****</b>				
	75,528	72,200	72,200	72,400
600. Pagat	59,528	56,700	56,700	56,700
<i>Kapitulli 01</i>	50,600	56,700	56,700	56,700
<i>Kapitulli 05</i>	0	0	0	0
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shendetësore	6,600	6,600	6,600	6,800
<i>Kapitulli 01</i>	6,600	6,600	6,600	6,800
<i>Kapitulli 05</i>	0	0	0	0
602. Mallrat dhe shërbimet	7,400	7,400	7,400	7,400
<i>Kapitulli 01</i>	7,400	7,400	7,400	7,400
<i>Kapitulli 05</i>	0	0	0	0
603. Subvencionet	0	0	0	0
<i>Kapitulli 01</i>	0	0	0	0
<i>Kapitulli 05</i>	0	0	0	0

604. Transferta të brendshme	0	0	0	0
<i>Kapitulli 01</i>	0	0	0	0
<i>Kapitulli 05</i>	0	0	0	0
605. Transferta të jashtme	0	0	0	0
<i>Kapitulli 01</i>	0	0	0	0
<i>Kapitulli 05</i>	0	0	0	0
606. Transferta për familjet dhe individët	0	0	0	0
<i>Kapitulli 01</i>	0	0	0	0
<i>Kapitulli 05</i>	0	0	0	0
230. Aktivët e patrupëzuara	0	0	0	0
<i>Kapitulli 01</i>				
<i>Kapitulli 02</i>				
<i>Kapitulli 03</i>				
<i>Kapitulli 04</i>				
231. Aktivët e trupëzuara	2,000	1,500	1,500	1,500
<i>Kapitulli 01</i>	2,000	1,500	1,500	1,500
<i>Kapitulli 02</i>				
<i>Kapitulli 03</i>				
<i>Kapitulli 04</i>				
<b>Kontroll</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Nepunesi Zbatues	Adelina Kastrati
	
	26.4.2022

Koordinatori i GMS/ Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Nenshkrimi	
	Data	26.4.2022

**Rrjeshti "Kontroll" shërben për të kontrolluar nëse është bërë ndonjë gabim llogjikë. Ai kontrollon që totali i kostos së produktit është i barabartë me totalin e kostos së produktit sipas artikujve ekonomik. Në rast se ky total nuk është në rregull, formula gjeneron automatikisht mesazhin "Error", duke ju paralajmëruar që është bërë një gabim.**

Koordinatori i GMS/ Nepunesi Autorizues	Emri	
	Nenshkrimi	
	Data	




**FORMATI 4: ALOKIMI I TAVANEVE PËR POLITIKAT EKZISTUESE**


63	Emri i Grupit	Veprimtaria e komisionerit publik
----	---------------	-----------------------------------

Artikujt	Buxheti	PBA 2023 - 2025		
	2022	2023	2024	2025
Paga (600-601)	66,128	63,300	63,300	63,300
Korente të Tjera (602-606)	7,400	7,400	7,400	7,400
Kapitale (230-232) Të Brendshme	2,000	1,500	1,500	1,500
Kapitale (230-232) Të Huaja				
Jashtë-buxhetore				
<b>Totali</b>	<b>75,528</b>	<b>72,200</b>	<b>72,200</b>	<b>72,200</b>

**Kujdes!!**


Totali i tavanit të Njesisë së Qeverisjes Qendrore duhet të jetë i barabartë me totalin e tavanit të njesisë të shpërndarë nga Ministria përgjegjëse për financat me VKM e tavaneve.


Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati
	Nenshkrimi	
	Data	26.4.2022

Koordinatori i GMS/ Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Nenshkrimi	
	Data	26.4.2022

**FORMATI 5: SHPENZIMET PËR FINANCIMIN E POLITIKAVE EKZISTUESE PËR PROJEKTET NË VAZHDIM**

Titulli i projektit	Kodi i projektit	Data e fillimit dhe përfundimit	Totali i shpenzimeve të investimeve kapitale të projektit *	Progresi financiar ndaj Kostos Totale (%)**	Buxheti i miratuar për 2022	Totali i shpenzimeve të investimeve kapitale(të gjitha burimet)*			Buxheti i Shtetit*			Statusi i Projektit****
						2023	2024	2025	2023	2024	2025	
	1	2	3	4	5	6 (9+12+15+18)	7 (10+13+16+19)	8 (11+14+17+20)	9	10	11	25
Programi 1												
<i>Totali për programin</i>					2000	1500	1500	1500	0	1500	1500	0
Pajisje Elektronike	M630013				1000	850	850	850	0	850	850	
Mobilje per zyrat	M630002				1000	650	650	650	0	650	650	
Projekti 3												

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati
	Nenshkrimi	
	Data	26.4.2022

Koordinatori i GMS/ Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Nenshkrimi	
	Data	26.4.2022